

VENDIM
Nr. 494, datë 1.8.2012

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “KOLEGJI
PROFESIONAL I SPORTEVE, FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier”, në emër të shoqërisë “Akademia e Sporteve, Fier” sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në këtë qytet.

2. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” të ketë njësi përbërëse organizative Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, i cili do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë, në “Edukim fizik dhe sporte”.

3. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë, në “Edukim fizik dhe sporte”, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike, që realizohet me 180 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Edukim fizik dhe sporte”.

4. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë i ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi e programe dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programit të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha